

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it, në bashkëpunim me DRTK Gjirokastër dhe Njësinë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë zhvilluan aktivitetin me temë: Rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi i studentëve mbi asetet historike që posedon qyteti jonë, ku menaxhimi solid është faktor kyç për mbrojtjen, promovimin dhe bartjen e suksesshme të trashëgimisë kulturore tek gjeneratat e ardhshme.

Gjatë aktivitetit u zhvilluan diskutime dhe shkëmbime mendimesh mes studentëve dhe specialistëve të DRTK-së, duke krijuar një hapësirë bashkëbisedimi dhe reflektimi mbi rëndësinë e ruajtjes së vlerave kulturore.

